

Në bazë të nenit 7, alineja 9 nga Ligji për themelim të Agjencisë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/07, 5/09, 43/14, 193/15, 39/16, 164/18) dhe ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 190/19), Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural e publikon këtë:

## T H I R R J E P U B L I K E n r . 2 / 2 0 2 1

### për parashtrim të kërkesave për pagesë të mjeteve nga Programi për mbështetje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2021

#### I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpallje është shpërndarja e mbështetjes financiare për nënpikat e masave në vijim:

Masa 1	Përkrahje financiare në peshkatari	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues
Nënpika 1.6	Mbrojtje plotësuese të peshqve në ujërat e peshkimit	- deri 30.000 denarë për mbrojtjen e riverave për peshkim dhe zonave rekreative - deri 150.000 denarë për mbrojtjen e zonave për peshkim - deri 400.000 denarë për mbrojtjen e rajoneve për peshkim

Masa 2	Përkrahje financiare në akuakulturë	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme
Nënpika 2.2	Mbështetje financiare për materialin për kultivimin e peshqve	- 40% nga vlera e të vegjlit të furnizuar ose të tyre

#### II. TË DREJTË NË SHFRYTËZIM TË MJETEVE

Të drejtë në shfrytëzim të mjeteve sipas nënpikave kanë:

Subjektet	Nënpika
<ul style="list-style-type: none"> <li>Koncesionerët e peshqve nga ujërat e peshkimit. Një koncesioner mund të shfrytëzojë mjete vetëm për një periudhë të caktuar të hedhjes natyrale të vezëve dhe ndalesës për peshkim</li> </ul>	1.6
<ul style="list-style-type: none"> <li>Subjekte të cilët posedojnë leje për prodhim të materialit për kultivim të peshqve nga basenet e parapara për shitje dhe nuk kanë të importuar material për kultivimin e peshqve dhe peshk të gjallë në periudhën dhjetor 2020-dhjetor 2021 nga lloji i peshkut për të cilin kanë leje për prodhim të materialit për kultivim të peshqve për kultivim të baseneve të peshqve</li> <li><b>Për të vegjlit e furnizuar</b>, subjekte të cilat janë të regjistruar në veprimtari akuakulturë dhe janë të regjistruar në regjistrin për mirëmbajtje të peshqve e cila mbahet në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave dhe kanë të blerë të vegjël nga subjekte të cilët posedojnë leje për prodhim të materialit për kultivim të peshqve nga basenet e peshqve të paraparë për shitje dhe të cilët nuk kanë importuar material për kultivimin e peshqve dhe peshk të gjallë në periudhën prej dhjetor 2020 – dhjetor 2021.</li> </ul>	2.2

#### III. SHUMA E MBËSHETJES FINANCIARE

Mjetet nga nënpika 1.6 janë të parapara për kompensim të shpenzimeve të pranueshme për mbrojtje fizike të plotësueshme të peshqve e cila bëhet në periudhën e hedhjes natyrale të vezëve të peshqve të përcaktuar në bazën e peshkatarisë dhe vendimit të sjellur për ndalim të peshkimit në ujërat e caktuara të peshkimit për periudhën prej 1 prill 2021 deri 15 korrik 2021 edhe atë shpenzimet e bëra për:

- shërbime nga persona të tretë (rojtare të peshqve) për mbrojtje fizike të peshqve në shumën prej jo më shumë se bruto paga mujore mesatare në veprimtarinë për personin e angazhuar
- karburant i furnizuar për mjetet lundruese në pronësi të koncesionerit ose i dhënë për shfrytëzim të koncesionerit
- karburant i furnizuar për makinat në pronësi ose të dhëna për shfrytëzim të koncesionerit
- marrje me qira të mjeteve lundruese nga persona të tretë

Mjetet nga nënpika 2.2 janë të parapara për furnizim të materialit për kultivimin e peshqve për kultivimin e baseneve të peshqve në periudhë prej 1 korrik deri 30 shtator 2021

Mjetet nga nënpika 2.2 paguhet gradualisht edhe atë:

- për kilogram të blerë ose të kultivuar të të vegjëlve deri 2.500 kilogramë - 100% nga vlerata e çmimit të caktuar të të vegjëlve
- për kilogram të blerë ose të kultivuar të të vegjëlve prej 2500 deri 5000 kilogramë - 75% nga vlerata e çmimit të caktuar të të vegjëlve,
- për kilogram të blerë ose të kultivuar të të vegjëlve prej 5000 deri 7500 kilogramë - 50% nga vlerata e çmimit të caktuar të të vegjëlve
- për kilogram të blerë ose të kultivuar të të vegjëlve mbi 7500 kilogramë - 25% nga vlerata e çmimit të caktuar të të vegjëlve.

#### IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI PARASHTROHET

Kërkesat për nënpikat veçmas parashtrohen në formën origjinal.

Kushtet të cilat duhet ti plotësojnë kërkuessit e mjeteve janë të përcaktuara në Programin për mbështetje financiare për peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2021 ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 14/2021).

**Nëse deri te Agjencia janë parashtruar më shumë kërkesa se sa që ka mjete në dispozicion sipas Programit për mbështetje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2021, Agjencia do t'iu jep përparësi kërkuessve të cilët e kanë parashtruar kërkesën e tyre para tjerëve.**

#### V. TËRHEQJE TË FORMULARËVE DHE UDHËZIME

Formularët "Kërkesa për pagesë" me listën e dokumenteve të duhura dhe Udhëzimi për shfrytëzuesit mund të tërhiqet në ueb-faqen e Agjencisë [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

Formularët e lartpërmendur mund të tërhiqen edhe direkt në Agjencinë çdo ditë pune nga ora 8:30 deri 14:30 në adresën:

**Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,  
bul. "3-ta Makedonska brigada" nr. 20  
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)  
1000 Shkup**

#### MËNYRA E PARASHTRIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuar për pagesë të mjeteve nga Programi për mbështetje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2020 së bashku dokumentacionin e tërësishëm të duhur parashtrohen në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur në të cilin në anën e përparshme në këndin e lartë të majtë qëndron shkrimi "MOS E HAP", për Thirrjen publike numër 02/2021 dhe theksimi i shifrës së nënpikës për të cilin parashtrohet kërkesa. Kërkesa mund të parashtrohet përmes postës ose personalisht në sportelin e Agjencisë. Nëse zarfi nuk është i shënuar ashtu siç kërkohet, Agjencia nuk merr përgjegjësi për arritje të vonuar dhe të jo kompletuar në sportelin dhe hapjen e parakohshme të kërkesës.

**Afati i fundit për parashtrim të kërkesave për pagesë të mjeteve:**

#### Për nënpikën 1.6

- për kryerjen e mbrojtjes plotësuese fizike të peshqve në periudhën prej 1 prill 2021 deri 15 korrik 2021, afati përfundimtar është **24 dhjetor 2021**

#### Për nënpikën 2.2

- për kultivim të baseneve të peshqve në periudhën prej 1 korrik deri 30 shtator 2021, afati i fundit është **24 dhjetor 2021**.

**Kërkesat e parashtruara pas afatit të paraparë nuk do të mbikëqyren.**

Informata më të hollësishme në kontakt tel: (02) 3097-450 ose në e-mail adresën [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk) dhe ueb-faqen [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk) ose [www.pa.gov.mk](http://www.pa.gov.mk).

Kontakt:

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për miratimin e pagesave.

Telefoni: **02 3097 - 450**, çdo ditë pune nga ora 08:30 deri 16:30.

E-mail: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk)

